



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR. 58, Datë 05.04.2019

**PËR SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT PËR PROKUROR PRANË PROKURORISË
SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 166, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të nenit 7 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të nenit 47 pika 1, gërma b të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

- I. Të skualifikojë Znj. Irena Nino, kandidat për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, e cila pas vlerësimit paraprak rezulton se aktualisht nuk është pjesë e sistemit të prokurorisë, duke mos plotësuar kushtet ligjore për ngritjen në detyrë, parashikuar në nenin 47 pika 1, gërma b të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *“Ngritja në detyrë është kalimi nga një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrative në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme”*.
- II. Të njoftohet me këtë vendim Znj. Irena Nino.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI

ALFRED BALLA





ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR
GENTIAN OSMANI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BESNIK CANI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ